

**AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**  
**(ASIG)**

**PLANI I KOMUNIKIMIT**

Miratohet

**Vilma TOMÇO**

*Drejtor i Përgjithshëm*



# PLANI I KOMUNIKIMIT - ASIG

## RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në rrugëtimin e tij drejt përmbushjes së objektivave dhe synimeve institucionale i kushton komunikimit dhe promovimit të produkteve dhe shërbimeve të tij një rëndësi të veçantë në veprimtarinë e përditshme.

Hartimi i këtij plani komunikimi, i shoqëruar me një plan të detajuar veprimi, konkretizon strategjinë e zgjedhur nga ASIG për të pasqyruar hap pas hapi me transparencë dhe korrektesë të plotë çdo zhvillim apo ngjarje si dhe ecurinë e çdo nisme të rëndësishme që ky institucion ndërmerr.

Nisur nga objektivat madhore të ASIG, për realizimin e misionit të tij i cili është krijimi i Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri (NSDI), si më poshtë:

- ✓ Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare për të mundësuar mbështetjen e punimeve gjeodezike dhe hartografike në Republikën e Shqipërisë, sipas standardeve evropiane,
- ✓ Ngritja e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit Kombëtar si komponentët themelorë të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë,
- ✓ Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet publike përgjegjëse, për temat e nenit 11 të ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” për hartimin dhe implementimin e standardeve të gjeoinformacionit si dhe përditësimin e vazhdueshëm të informacionit gjeohapësinor,
- ✓ Administrimi, përpunimi dhe shërbimi i produkteve të përftuara nga të dhënat e mbledhura me teknologjinë Remote Sensing.

ASIG ka hartuar këtë plan komunikimi i cili do të ndihmojë në krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e gjeoinformacionit, nisur dhe nga roli koordinues dhe mbikëqyrës që ASIG ka.

Me fokus në informimin e opinionit të gjerë dhe sigurimit të mbështetjes publike për realizimin e misionit dhe detyrave institucionale, mesazhet e përcjella duhet të kenë për qëllim rritjen e imazhit të ASIG, besimin te publikut dhe perceptimin gjithmonë e më pozitiv tek njerëzit për vlerat dhe rolin e rëndësishëm të informacionit gjeohapësinor për mbarë shoqërinë. Qartësia dhe

qëndrueshmëria e komunikimit tonë ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si aktorët e brendshëm dhe të jashtëm e shikojnë dhe e vlerësojnë ASIG në realizimin e misionit të tij në krijimin dhe zhvillimin e NSDI në Shqipëri.

Publiku duhet të informohet në mënyrë të tillë që të kuptojë sa më qartë të jetë e mundur rëndësinë që informacioni gjeohapësinor ka në ditët e sotme, sa koherent është ASIG në ofrimin e tij konform standardeve evropiane, duke ndjekur zhvillimet më të fundit teknologjike dhe impaktin që kanë produktet e ASIG në të gjitha fushat ku gjejnë përdorim.

## OBJEKTIVAT

- ✓ Të bëhen publike lehtësirat që ka krijuar ASIG për Autoritetet Publike Përgjegjëse dhe të gjithë ata që mbledhin, përpunojnë dhe përditësojnë informacion gjeohapësinor.
- ✓ Të pasqyrohet se sa shpejt, saktë dhe lehtësisht aksesohen të dhënat dhe shërbimet që u ofrohen përdoruesve on-line në Gjeoportalin Kombëtar.
- ✓ Të shtohen urat e komunikimit mes ASIG dhe përdoruesve të gjeoinformacionit nëpërmjet realizimit të anketimeve të ndryshme on-line me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe lehtësirave të ndryshme të propozuara nga to.
- ✓ Të fuqizohet imazhi i ASIG nëpërmjet organizimit të fushatave të ndryshme promovuese të aktivitetit të tij.
- ✓ Rritja e nivelit të informacionit dhe transparencës te publiku mbi aktivitetet ASIG.
- ✓ Të pasqyrohen në kohë reale trajnimet e realizuara nga ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafeve teknike të autoriteteve publike përgjegjëse, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë që krijojnë dhe përdorin të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore.

## PARIMET E KOMUNIKIMIT

Parimet mbi të cilat bazohet komunikimi në ASIG janë:

- Përgjegjshmëria** → Të qenit të përgjegjshëm në lidhje me gjithçka transmetohet apo ju komunikohet të tjerëve.
- Saktësia dhe qartësia** → Mesazhi që përcjellim duhet të jetë sa më i saktë, konciz dhe i qartë në mënyrë që të merret shpejt nga publiku dhe ti shërbejë atij.
- Kreativiteti dhe risitë** → Mënyra që zgjedhim për të komunikuar duhet drejtuar gjithmonë drejt trendeve bashkëkohore, ndaj dhe për ne është me rëndësi të nxisim ide të reja krijuese dhe të shfrytëzojmë risitë më të fundit në botën e komunikimit.

**Transparenca dhe paanshmëria** → Çelësi i suksesit të komunikimit për ne është të jemi transparent, besnikë dhe të paanshëm kundrejt audiencës sonë dhe palëve të interesit.

## MËNYRA E KOMUNIKIMIT

### Interneti

Një pjesë integrale e komunikimit të suksesshëm me audiencën tonë të identifikuar, është zgjedhja e kanalit të duhur të komunikimit.

*Qëllimi është informimi, ndikimi dhe frymëzimi.*

Për të bashkërenduar tërësinë e veprimeve që kontribuojnë në një komunikim sa më efektiv, lehtësisht dhe masivisht të aksesueshëm, kemi përzgjedhur këto mjete komunikimi në ASIG;

- ✓ <http://www.asig.gov.al/>,
- ✓ <http://www.asig.gov.al/index.php/geoportal>,
- ✓ [https://krgjsh.asig.gov.al/?page\\_id=1210&lang=en](https://krgjsh.asig.gov.al/?page_id=1210&lang=en),
- ✓ <https://www.youtube.com/@asiggeoportal1155>,
- ✓ [info@asig.gov.al](mailto:info@asig.gov.al),
- ✓ <https://www.linkedin.com/company/91618757/admin/feed/posts/>,
- ✓ <https://www.facebook.com/ASIG2015/>,
- ✓ [https://www.instagram.com/autoriteti\\_shteteror\\_asig/?igshid=MWdtcGdpMjZ5Y2N1NA%3D%3D](https://www.instagram.com/autoriteti_shteteror_asig/?igshid=MWdtcGdpMjZ5Y2N1NA%3D%3D).

### Media e shkruar dhe audiovizive

Pasqyrimi i çdo aktiviteti madhor të ASIG në media është pa diskutim mënyra më e mirë për ta bërë sa më publike veprimtarinë e institucionit tonë dhe për të sjellë sa më pranë audiencës vizionin e ASIG.

- ✓ Prezantime nëpër evente të ndryshme, video, reklama etj.
- ✓ Materiale të printuara baner, fletëpalosje, fotografi, grafike apo raporte.

- ✓ Broshura dhe buletine.
- ✓ Takime promovimi nëpër institucione të ndryshme.

## ROLI DHE PËRGJEGJËSITË

Komunikimi në ASIG është përgjegjësi e Sektorit të Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore.

Struktura e komunikimit dhe e informacionit publik vepron në mënyrë të integruar, sinergjike dhe me një qasje të përbashkët, nga të gjithë sektorët e ASIG, gjithashtu çdo punonjës në të gjitha nivelet, duhet të jetë i vetëdijshëm se është pjesë integrale shumë e rëndësishme e përmbushjes së misionit të komunikimit dhe përcjelljes te publiku të vizionit të ASIG.

Sektorët apo personat e ngarkuar në ASIG përgatisin materialet për komunikim sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.

Personi përgjegjës në Sektorin e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore ndjek në mënyrë periodike zbatimin e Planit të Veprimit duke bashkëpunuar me personat apo sektorët e ngarkuar për secilën veprimtari.

Përgjegjësi i sektorit kontrollon zbatimin e plani të veprimit sipas afateve të vendosura.

Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori i Përgjithshëm informohen dhe konsultohen me draft dokumentet që përgatiten për publikim.

Në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë dhe përgjegjës të sektorit hartohet Plani i Veprimit me objektiva specifike si dhe me detyrat përkatëse për secilin punonjës të këtij sektori.

## ANALIZA E PALËVE TË INTERESIT DHE GRUPEVE TË SYNUARA

Bazuar në misionin, objektivat dhe përgjegjësitë e ASIG, palët e interesit dhe grupet e synuara të komunikimit tonë janë:

**Autoritetet Publike Përgjegjëse** për temat e gjeoinformacionit pasi sa më i suksesshëm të jetë produkti që vjen nga bashkëpunimi me ta, aq më shumë rriten vlerat e ASIG bazuar në rolin menaxherial, koordinues e bashkërendues që ai ka me këto autoritete.

**Institucionet shtetërore** në nivel qendror e lokal përdorin në veprimtarinë e tyre gjithnjë e më shumë informacion gjeohapësinor. Lehtësirat që ASIG iu krijon atyre për akses dhe përdorim të shpejtë e të saktë të këtij informacioni ndihmojnë drejtpërdrejt në punën e tyre.

**Përdoruesit e Gjeoinformacionit** janë ambasadorët tanë më të mirë, të cilët janë gjatë gjithë kohës në kontakt me shërbimet që ne ofrojmë. Ata janë testuesit e parë që konstatojnë nëse një e dhënë apo shërbim i publikuar është i vlefshëm apo jo, ndaj dhe komunikimi me ta ka rëndësi të veçantë për institucionin tonë.

**Bota akademike**, universitetet në ditët e sotme priren ti orientojnë kurikulat e tyre drejt fushave inovative përfshirë atë të gjeoinformacionit. Shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme, organizimi i workshop-ve apo praktikave të shumta duke ju vënë në dispozicion atyre çdo informacion të nevojshëm gjeohapësinor i ka bërë ata të jenë bashkëpunëtorët tanë të ngushtë

**Bashkëpunëtorët ndërkombëtarë**, shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme me bashkëpunëtorë të huaj në kuadër projektesh të shumta që ASIG ndërmerr ka sjellë përmirësimin e infrastrukturës me të cilën ASIG operon si dhe rritjen profesionale të stafit të tij. Konkretizimi i frymës bashkëpunuese mes palëve përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit, ndaj promovojmë vijueshmërinë e bashkëpunimeve të tilla gjithnjë e në rritje.

**Mediat**, mbështetja e mediave është një faktor i rëndësishëm në fushën komunikimit. Prania e tyre në eventet më të rëndësishme të ASIG dhe promovimi që ato i bëjnë produkteve apo arritjeve të ASIG do të përmirësojnë imazhin e tij dhe do të përcjellin sa më pranë publikut vizionin e ASIG.

## MESAZHET QË PËRCJELLIM

ASIG është gjithmonë i fokusuar që produktet e tij primare të cilat janë Gjeoportali Kombëtar, Imazheria Satelitore dhe UAV, Rrjete gjeodezike, Hartografia, Standardet e gjeoinformacionit, të vijnë pranë publikut dhe palëve të interesit në mënyrën sa më të shpejtë, më të saktë dhe më transparente të mundshme.

Mesazhet që duam ti përçojmë publikut me anë të komunikimit janë :

- ✓ Produktet dhe shërbimet e ASIG janë të një rëndësie të veçantë si për popullatën dhe për qeverisjen pasi ato sjellin një ndihmesë të madhe në hartimin e politikave të drejta dhe të sakta në fushën e gjeoinformacionit.
- ✓ Bashkëpunimi me Autoritetet Publike Përgjegjëse dhe palët e interesit për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor është primar për ASIG bazuar në rolin e tij koordinues.
- ✓ Të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore të ofruara në Gjeoportalin Kombëtar janë të përditësuara, të standardizuara dhe lehtësisht të aksesueshme.
- ✓ Saktësia, transparencat dhe korrektësia e ASIG në informacionet që përcjell.

## PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Aktiviteti	Materialet e publikimeve	Afati kohor	Personi përgjegjës	Burimi i informacionit	Mënyra e komunikimit	Grupi i synuar
1	Promovim dhe publikim i akteve rregullatorë të miratuara në ASIG	1. Akte ligjore e nënligjore 2. Standarde 3. Udhëzues teknikë 4. Manuale (procedurale e teknike)	Brenda 2 ditë pune nga miratimi i tyre	Elfrida Kolbuçaj Eugerta Teqja	Sektori që e miraton aktin + Sektori Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore	Faqja zyrtare e ASIG Gjeoportali Kombëtar.	Autoritetet përgjegjëse, Publiku + Palët e interesit
2	1. Promovim dhe publikim i produkteve dhe aktiviteteve të ASIG bazuar në objektivat vjetore të punës.	1. Infrastrukturë komunikimi dhe ndërveprim. 2. Sisteme GIS 3. Rrjete gjeodezike 4. Hartografi 5. Përpunim digjital 6. Shtresa gjeohapësinore 7. Të dhëna gjeohapësinore 8. Shërbime gjeohapësinore	Brenda 2 ditë pune nga finalizimi i produktit	Eugerta Teqja	Të gjithë sektorët e ASIG	Faqja zyrtare e ASIG Gjeoportali Kombëtar, Rrjetet sociale të ASIG Organizim eventesh.	Publiku + Palët e interesit



		<p>9. Produkte nga Përpunimi i Imazheve Satelitore.</p> <p>10. Produkte nga Përpunimi i të dhënave 360°</p> <p>11. Administrim i burimeve njerëzore</p> <p>12. Administrim i prokurimeve</p> <p>13. Administrim i financës dhe buxhetit.</p>					
3	<p>Takime periodike, me palët e interesit (Institucione publike e private) me qëllim njohjen e tyre me produktet e reja të ASIG.</p>	<p>1. Produktet e ASIG që do t'ju prezantohen palëve të interesit.</p> <p>2. Foto të takimeve</p>	<p>Çdo 3 muaj</p>	<p>Eugerta Teqja</p>	<p>Palët e interesit me fokus të përbashkët në produktet e ASIG.</p>	<p>Takime të drejtpërdrejta në ASIG me grupet e synuara.</p>	<p>Publiku + Palët e interesit</p>
4	<p>Promovim dhe publikim i bashkëpunimeve të ASIG në kuadër të projekteve me palët e treta.</p>	<p>1. Takime apo konferenca në kuadër të projektit që ASIG po zhvillon. 2. Workshop-e apo trajnime të ndryshme të realizuara në kuadër të projektit.</p>	<p>Brenda 2 ditë pune nga përfundimi i eventit me projektin përkatës.</p>	<p>Eugerta Teqja</p>	<p>Spektori i Projekteve në ASIG\Koordinatori i projektit. Spektori i trajnimeve për Gjeoinformacionin</p>	<p>Faqja zyrtare e ASIG Gjeoportali Kombëtar, Rrjetet sociale të ASIG</p>	<p>Publiku + Palët e interesit</p>

5	Promovimi dhe publikimi i takimeve të Bordit të Informacionit Gjeohapësinor	1.Agjenda e takimit 2.Pjesëmarrësit 3.Nismat e prezantuara 4.Aktet e miratuara	Brenda 2 ditë pune nga mbyllja e takimit	Elfrida Kolbuçaj Eugerta Teqja	Sektori i koordinimit dhe çështjeve ligjore	Faqja zyrtare e ASIG Gjeoportali Kombëtar, Rrjetet sociale të ASIG	Anëtarët e BIG, Autoritetet Publike përgjegjëse + Palët e interesit
6	Pasqyrim i komunikimit me autoritetet publike përgjegjëse lidhur me: -Nismat në fushën e gjeoinformacionit -Publikimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore në Gjeoportalin Kombëtar.	1.Projekte 2.Sisteme 3.Përditësime 4.Trajnime	Brenda 2 ditë pune nga mbyllja e takimit	Elfrida Kolbuçaj Eugerta Teqja	Autoriteti publik përgjegjës, Drejtoritë teknike të ASIG, Sektori i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, Sektori i Projekteve, Sektori i Trajnimeve për Gjeoinformacionin.	Faqja zyrtare e ASIG Gjeoportali Kombëtar, Rrjetet sociale të ASIG	Publiku +Autoritetet Publike Përgjegjëse, Palët e interesit
7	Komunikim me përdoruesit e Gjeoportalit Kombëtar lidhur me të dhënat dhe shërbimet që ofrohen prej tij si dhe komunikimi me	1.Komunikim periodik me përdoruesit e regjistruar 2.Kërkesë për informacion 3.Harta 4.Të dhëna 5.Shërbime	Brenda 7 ditësh nga kërkesa	Eugerta Teqja Sektori i GIS Kombëtar dhe Gjeoportalit Sektori i Infrastrukturës së Sistemeve CORS	Sektori i Koordinimit dhe çështjeve ligjore, Sektori i GIS Kombëtar, Sektori i Infrastrukturës së sistemeve CORS	<a href="mailto:info@asig.gov.al">info@asig.gov.al</a> <a href="mailto:info@gjeoportali.gov.al">info@gjeoportali.gov.al</a> <a href="mailto:info.albcors@asig.gov.al">info.albcors@asig.gov.al</a>	Publiku + Përdoruesit e Gjeoportalit Kombëtar. Përdoruesit e Sistemit ALBCORS

	përdoruesit e Sistemit CORS						
8	Pasqyrim dhe publikim i bashkëpunimit të ASIG me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare që përdorin informacionin gjeohapësinor.	1.Takime 2.Shërbimet e përdorura 3.Foto, video	Brenda 2 ditë pune nga mbyllja e takimit	Eugerta Teqja	Sektori që është në bashkëpunim me këto institucione	Faqja zyrtare e ASIG në web, Gjeoportali Kombëtar, Rrjetet sociale të ASIG	Publiku + Palët e interesit
9	Pasqyrim dhe publikim i Workshop -eve e trajnimeve të ndryshme mbi rritjen e kapaciteteve të punonjësve të ASIG dhe APP	1.Programi i trajnimit 2.Ekipi trajnues 3.Stafi i trajnuar 4.Foto Video	Brenda 2 ditë pune nga mbyllja e aktivitetit	Eugerta Teqja	Sektori i Trajnimeve për Gjeoinformacionin, Sektori pjesëmarrës në WORKSHOP	Faqja zyrtare e ASIG Gjeoportali Kombëtar, Rrjetet sociale të ASIG	Stafi ASIG + AP
10	Promovimi i bashkëpunimit të ASIG me institucionet e edukimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit në fushën e	1. Workshop-e 2. Leksione/seminare 3.Trajnime 4. Asistencë 5. Sfida dhe konkurse	Brenda 2 ditë pune nga mbyllja e aktivitetit	Eugerta Teqja	Sektori në bashkëpunim me institucionet e edukimit	Faqja zyrtare e ASIG dhe Rrjetet sociale të ASIG	Bota akademike + Publiku

	gjeoinformacionit .						
11	Pasqyrim dhe publikim i bashkëpunimeve mes Sektorit të Infrastrukturës së Sistemeve CORS dhe përfaqësuesve të ndryshëm të biznesit.	Takime sipas parashikimeve të Sektorit i Infrastrukturës së sistemeve CORS	Brenda 2 ditë pune nga mbyllja e takimit	Eugerta Teqja	Sektorit i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore në bashkëpunim me Sektorin e Infrastrukturës së Sistemeve CORS	Faqja zyrtare e ASIG dhe Rrjetet sociale të ASIG	Publiku, Autoritetet përgjegjëse, përdoruesit e Sistemit ALBCORS
12	Promovimi i bashkëpunimeve ndër sektoriale në ASIG	Produktet e grupeve ndër sektoriale të punës	Brenda 2 ditë pune nga finalizimi i produktit	Eugerta Teqja	Drejtuesit e grupeve të punës	Faqja zyrtare e ASIG, Rrjetet sociale të ASIG Share folder Institucional	Palët e interesit + Publiku
13	Materiale promovuese bazuar në objektivat vjetore të punës.	Buletine, broshura, fletëpalosje.	Brenda 2 ditë pune nga finalizimi i produktit	Eugerta Teqja	Sektorit i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, Sektorit i trajnimeve për gjeoinformacioni	Faqja zyrtare e ASIG në web, Rrjetet sociale të ASIG	Palët e interesit + Publiku

14	Statistikat e gjeneruara nga Gjeoportali Kombëtar	Grafikë, print screen-e	Çdo 3 muaj	Eugerta Teqja	Spektori i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore + Spektori Gjeoportalit Kombëtar	Faqja zyrtare e ASIG në web dhe Rrjetet sociale të ASIG	Palët e interesit + Publiku
----	---	-------------------------	------------	---------------	---	---	-----------------------------